Ky aktivitet shoqerohet me gjenerim te mbetjeve te ngurta te cilat klasifikohen si skroje dhe vijne si rezultat i proceseve te furres rrotulluese. Keto mbetje do te transportohen, ruhen/magazionohen ne ambientet e shoqerise, ne sheshin e percaktuar nga drejtuesi i teknik. Ndersa mbetjet urbane te gjeneruara nga aktiviteti i punonjesve dhe administrata, do te grumbullohen ne konteniere te posacem dhe do te dergohen ne kontenieret e perbashket te Bashkise Elbasan per trajtimin dhe asgjesimin e metejshem te tyre ne Lendfillin rajonal.

### **Ndikimi social-ekonomik i aktivitetit**

Ndikimi social-ekonomik i ketij aktiviteti eshte vetem me efekte pozitive. Kjo pasi ky aktivitet nuk do te ndikojte negativisht as ne toke, as ne ajer as ne ujera, as ne mjedisin biologjik, si dhe nuk do te cenoje popullsin. Linja per prodhimin e oksidit te zinkut, eshte nje teknologji e cila trajton lendet e para me permbajtje te mineralit te zinkut duke punesuar nga komuniteti i zones, eshte nje ndikim pozitiv social. Ne kete aktivitet jane te punesuar disa persona dhe ne te ardhmen eshte projektuar qe te shtohet numri i punonjesve qe do te perfshihen ne kete aktivitet.

Informacion për shkarkimet në mjedis.

Shkarkimet ne mjedis te ketij aktiviteti jane:

1. Shkarkime ne ujera teknologjike nga procesi i prodhimit
2. Gjenerim te mbetjeve te ngurta nga proceset e prodhimit.
3. Gjenerim i zhurmes vetem ne ambjentin e punes.
4. Gjenerimi i gazeve dhe pluhurave nga furra rrotulluese
5. Ndotje e mjeteve te transportit dhe te punes.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

| <b>Rekomandime për zbutjen e ndikimeve</b>   |   |
|--|---|
| <b>Toka</b>  |   |
| <b>Përdorimi i Tokës</b>   | Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.  |
| <b>Biodiversiteti</b>  |   |
| <b>Vejetacioni<br/>Dëmtim potencial i<br/>vegjetacionit</b>                                | Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria.<br>Mbjellja e fidaneve të rinj, përgjate rruges që bëhen të mundur hyrjen për në objekt.<br>Menaxhimi dhe administrimi i mbetjeve industriale, sipas kushteve dhe standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare.   |
| <b>Cilësia e ajrit</b>   |   |
| <b>Shkarkimet në ajër</b>  | Oxhaku i furrës është e pajisur me një sistem filtrash, të cilët shërbejnë për kapjen e gazrave që gjenerohen nga procesi i prodhimit të oksidit të zinkut  |
| <b>Sistemi i drenazhimit</b>   |   |
| <b>Sistemi i drenazhimit</b>   | Mirëmbajtja e sistemit të drenazhimit të ujërave të shiut dhe ujërave të pastrimit përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, shkarkimi i tyre brenda normave të lejuara në rrjetin e kanalizimeve të zonës.  |
| <b>Zhurmat</b>   |   |
| <b>Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti/ instalimet dhe nga lëvizja e automjeteve</b> | Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Përdorimi i instalimeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës.<br>Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit).<br>Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjatë orareve të përshtatshme. |
| <b>Trafiku rrugor</b>  |   |
| <b>Trafiku Rrugor<br/>Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve</b>                   | Lëvizshmëria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do të levizën brenda normave të lejuara të shpejtësisë, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.  |



- **Masat teknike.**

- Ndjekja e gjithë kerkesave ligjore për veninë në funksion të aktivitetit duke mbajtur parasysh kufizimet dhe detyrimet kundrejt shtetit dhe paleve të treta.
- Aktiviteti kryesisht do të zhvillohet në ambient të mbyllur kështu që nuk do ketë nivele zhurmash domethënëse për zonën përreth. Do të bëhet pajisja e punonjësve me mjete mbrojtëse personale.
- Kompania ka ndertuar sistemin për ripërdorimin e ujërave teknologjike dhe krijimin e një cikli të mbyllur.
- Nga ky aktivitet nuk parashikohen të ketë ndikime në ndryshimin e habitateve
- Mbetjet e gjeneruara nga punonjësit do të grumbullohen në kaonteniere të vecante. Kontenieret do të zbrazen rregullisht dhe mbetjet do të hidhen në vendin e përcaktuar nga Njësia Vendore Bradashesh për mbetjet urbane.
- Do të ndiqen gjithë rregullat e sigurimit teknik në punë si dhe pajisjes së punonjësve me uniformat dhe mjetet e nevojshme të mbrojtjes në punë.

**Per me teper rekomandimet per te parandaluar dhe kontrolluar rrezikun e ndotjes perfshijme:**

- Mbetjet urbane të papërdorshme të grumbullohen transportohen dhe depozitohen në oraret e caktuara nga Njësia Vendore.
- Të realizohet ndriçimi përreth (vendosja e impiantit të ndricimit).
- Të kryhet rregullimi i territorit në përputhje me kondicionet urbane të përcaktuara.
- Shoqëria të operojë në përputhje të plote me normat që janë në fuqi, dhe të kryej monitorime të vazhdueshme të tregueseve mjedisor të trysisë në mjedis.
- Të respektoje të gjitha rregullat e mbrojtjes kundër zjarrit gjatë operimit dhe të respektoje rregulloren e MKZ.
- Të instalohen dhe të respektohen sinjalistikat e trafikut të cilat do të minimizojnë impaktin për aksidente të mundshme.
- Për të minimizuar impaktin ndaj zhurmave dhe vibrimeve, të limitohen proceset e zhurmshme gjatë orëve me të ndjeshme,
- Të respektoje të gjitha masat e përcaktuara në këto dokumente për menaxhimin e mjedisit.
- Të respektoje të gjitha kushtet dhe masat e miratuara në Lejen Mjedisore nga AKM-ja dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.

Nga vlerësimet e mesipërme, shkarkimet e pritshme në mjedis janë të ulëta dhe nuk përbejnë problem serioz për mjedisin. Megjithatë përparësitë që ka ky aktivitet, duhet të tregohet kujdes në menaxhimin dhe mbajtjen nën kontroll të kushteve teknike për të minimizuar humbjet aksidentale ose shkarkimet.

Masat që duhen konsideruar për të minimizuar ndikimin në mjedis janë:

- Parandalimi i shkarkimeve të mbetjeve industriale në mjedis, administrimi sipas rregulloreve përkatëse.
- Lidhur me mbetjet e gjeneruara nga procesi i prodhimit të zinkut, menaxhohen nga operatori, duke i dërguar në sheshin e depozitimit të mbetjeve (skorjeve) ku bëhet ruajtja/magazinimi i tyre sipas kerkesave dhe rregulloreve për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
- Sasia depozituese të mos i kalojë volumet e parashikuara në mënyrë që situata të jetë e kontrollueshme dhe të mos demtojë instalimin.
- Të zbatohet projekti i mbrojtjes nga zjarri në mënyrë që të përballojë sipërfaqen në rastet e avarive të ndryshme.

- Punonjesit te jene te trajnuar paraprakisht dhe te jene vazhdimisht ne mbikqyrjen e drejtuesit teknik gjate proceseve te punes. Punimet e mirembajtjes te kryhen ne perputhje me kushtet teknike te punes.
- Te mirembahet brezi i pemeve pergjate murit rrethues te prones, ne menyre qe te reduktoje impaktin ne peizazh.

### **Masat lehtesuese qe do të ndermerren gjate funksionimit te linjes se prodhimit**

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojta e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga shoqëria për funksionimin e linjes se prodhimit te oksidit te zinkut. Ndikimet negative në mjedis gjatë funksionimit te instalimeve janë në nivele të ulta. Disa prej masave kryesore që do të ndermerren janë permendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- Menaxhimi optimal dhe mirembajtja e linjes se prodhimit.
- Mbetjet e ngurta urbane te paperdorshme që do të prodhohen ne objekt të depozitohen në vëndet e përcaktuara nga Njësia Vendore dhe të vendosen kontenier te mjaftueshem për mbetjet për numrin e punonjësve, si dhe riciklimin e tyre nga subjekte te licencuara.
- Menaxhimi sa me eficient i lendes se pare.
- Të respektohen oraret e operimit të punës brenda mjedisit ku zhvillohet aktiviteti per prodhimin e oksidit te zinkut.
- Automjetet e transportit të qarkullojnë me shpejtësi të ulët në zonat e banuara.
- Zbatimi i niveleve kufi te zhurmave.

### **- ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;**

Shoqeria ALLIANCE RESOURCE Sh.p.k ka marrë me qira nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë më datë 02.05.2019, Nr. 1527 Rep, Nr. 464 Kol me sipërfaqe të përgjithshme 57390 m<sup>2</sup> në të cilën përfshihet "Objekti nr. 226 Depo e Koncentratit të Hekurit me sipërfaqe të përgjithshme 2655 m<sup>2</sup>, nga ku sipërfaqe ndërtimore 1500 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe funksionale 1155 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 611, Objekti 1-3G Vaska e Betonit, me sipërfaqe të përgjithshme 400 m<sup>2</sup> nga ku sipërfaqe ndërtimore 400 m<sup>2</sup> dhe truall 400 m<sup>2</sup> me nr. pasurie 624 dhe truall i lire me sipërfaqe të përgjithshme 54 335 m<sup>2</sup>, ZK 3965, Bradashesh, Elbasan. Këto objekte dhe sipërfaqja e lirë janë rikonstruuar dhe pershtatur per ushtrimin e veprimtarise "Linjë për prodhimin e oksidit të zinkut" i cili eshte ne perputhje me Planin e Pergjithshem Vendor dhe Planin e Detajuar Vendor te Bashkise Elbasan dhe Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise, duke qene se gjendet ne zonen industriale te Kombinatit Metalurgjik Elbasan. Prona ku eshte ngritur linja e prodhimit te oksidit te zinkut eshte ekzistuese, e pajisur me leje ndertimi dhe e marre me qira nga shoqeria.

- **MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

**Plani i Menaxhimit të Mbetjeve**

Aktiviteti që zhvillon shoqëria “ALLIANCE RESOURCE” Sh.p.k, në Kombinati Metalurgjik, Ish Uzina 12, Depo e Koncentratit, Zona Kadastrale 3965, Bradashesh, Elbasan nga proceset e ndryshme të operimit të punës në objekt për ofrimin e shërbimit Linje për prodhimin e oksidit të zinkut, referuar Lejes Mjedisore PN-9906-03-2020, Nr.2331Prot, date 10.03.2020, Nr. i Identifikimit të lejes 3137, K.Nr. 11 “Shkrirja dhe përfshirja e aliazheve të metaleve jo ferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi)” për nga vete natyra e instalimit, nga proceset e prodhimit të oksidit të zinkut gjenerohet një sasi mbetjesh të cilat janë urbane që gjenerohen nga administrata/punonjësit dhe mbetjet të skorjeve të cilat gjenerohen nga proceset e linjes së prodhimit të oksidit të zinkut.

- **Ndotja e mjedisit nga mbetjet e ngurta**

Nga zhvillimi i veprimtarisë Linje për prodhimin e oksidit të zinkut gjenerohet një sasi mbetjesh të cilat referuar Vendimit 99, date 18.02.2005 “Për Miratimin e Katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve” i ndryshuar klasifikohen si mbetje jo të rrezikshme. Keto mbetje sipas natyrës së gjenerimit të tyre dhe kategorisë, menaxhohen konform rregullave dhe kriterëve në përputhje me legjislacionin mjedisor dhe aktet ligjore në fuqi. Mbetjet e gjeneruara nga veprimtaria që zhvillon shoqëria ALLIANCE RESOURCE Sh.p.k kërkojnë një vlerësim rigoroz dhe një plan të detajuar të menaxhimit të tyre, duke ndjekur praktikën më të mirë në dispozicion. Mbetjet urbane që gjenerohen nga punonjësit dhe administrata, referuar karakteristikave të tyre ndahen sipas tipologjisë në kontener të posaçëm, sipas tipit dhe llojit të mbetjes ndërsa mbetjet teknologjike që gjenerohen nga proceset e prodhimit të oksidit të zinkut klasifikohen dhe ruhen/magazinohen në sheshin e depozitimit të mbetjeve brenda sipërfaqes së marre me qira.

- **Menaxhimi i mbetjeve**

Instalimi “Linje për prodhimin e oksidit të zinkut” për nga vete natyra e operacioneve, proceseve që zhvillohen i pozicionuar në Kombinati Metalurgjik, Ish Uzina 12, Depo e Koncentratit, Zona Kadastrale 3965, Bradashesh, Elbasan do të prodhojë “mbetje”. Nga aktiviteti i përditshëm i instalimit “Shkrirja dhe përfshirja e aliazheve të metaleve jo ferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuara (duke përfshirë rafinimin dhe derdhjen në fonderi)” të shoqërisë ALLIANCE RESOURCE Sh.p.k, dhe sipas kushtit të lejes mjedisore për menaxhimin e mbetjeve, gjenerohen keto tipe mbetjesh:

| Mbetja  | Kodi     | Pershkrimi (Vendi kryesor i gjenerimit)  | Menyra e trajtimit/asgjësimit   |
|---|----------|--|---|
| 10 05 Mbetje nga metalurgjia termike e zinkut |          |  |   |
| Zgryra nga prodhimi primar dhe dytësor        | 10 05 01 | Gjenerohen nga proceset që zhvillohen për prodhimin e oksidit të zinkut nëpërmjet furnes rrotulluese | Keto mbetje pasi gjenerohen nga proceset teknologjike grumbullohen dhe ruhen/magazinohen në sheshin e miratuara nga shoqëria. Operacionet që përdoren janë: |

|  |                 |  |   |
|--|-----------------|--|---|
| <p>Mbetje të tjera të imëta dhe pluhur</p> | <p>10 05 04</p> | <p>Gjenerohen nga proceset qe zhvillohen per prodhimin e oksidit te zinkut nepermjet fures rrotulluese</p> | <p>Shtojca 1 “Operacionet e asgjesimit”</p> <p>D15 Ruajtja/magaznimi në pritje të cilitdo prej operacioneve të renditura nga D 1 deri në D 14 (me përjashtim te ruajtjes paraprake në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).</p> <p>Shtojca 2 Operacionet e rikuperimit</p> <p>R 12 Shkëmbimi i mbetjeve për t’iu nënshtruar cilitdo nga operacionet e renditura nga R 1 deri tek R 11. Në qoftë se nuk ka një kod tjetër të përshtatshëm R, ky mund të përfshijë operacionet paraprake para rikuperimit përfshirë para-përpunimin siç është, inter alia, çmontimi, grumbullimi i diferencuar, thyerja/copëtimi, ngjeshja, peletizimi, tharja, grirja, zbutja, riambalazhimi, ndarja, bluarja apo përzjerja para dorëzimit në cilindo nga operacionet e numëruara R1 deri R11.</p> <p>R 13 Ruajtja e mbetjeve në pritje të cilitdo nga operacionet e renditura nga R1 deri në R 12 (me përjashtim te ruajtjes paraprake, në pritje të grumbullimit, në vendin ku mbetjet janë krijuar).</p> <p>Shoqeria eshte duke pare mundesine e rikuperimit, trajtimit dhe riperdorimit te ketyre mbetjeve ne industrite qe operojne ne territorin e Republikes se Shqiperise.</p> |
|--|-----------------|--|---|

| 20 01 Fraksionet e ndara (përveç 15 01)           |          |                             |  |
|---|----------|-----------------------------|--|
| Letër dhe karton                                  | 20 01 01 | Punonjesit dhe Administrata | Grumbullimi i mbetjeve ne 3-kosha sipas rrymave specike te mbetjeve<br><br>Vendepozitimi i Njesise Vendore Elbasan |
| Qelq  | 20 01 02 | Punonjesit dhe Administrata | Grumbullimi i mbetjeve ne 3-kosha sipas rrymave specike te mbetjeve<br><br>Vendepozitimi i Njesise Vendore Elbasan |
| Mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat | 20 01 08 | Punonjesit dhe Administrata | Grumbullimi i mbetjeve ne 3-kosha sipas rrymave specike te mbetjeve<br><br>Vendepozitimi i Njesise Vendore Elbasan |

Proceset kryesore per menaxhimin e integruar te mbetjeve jane:

- **Rikuperimi i mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme**

Ne zbatim te Ligjit Nr. 10 463, date 22.9.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” operacionet qe do te zhvillohen per rikuperimin e mbetjeve jane ato R4 Riciklimi/ripërtëritja e metaleve dhe komponimeve të tyre. Mbetjet te cilat kane permbajtje te larte te zinkut dhe kryesisht gjenerohen nga industrite e nxjerrjen se mineraleve metalore, mbetjet e kimise minerale, industria e shkrirjes dhe perpunimit te metaleve ferrose dhe jo ferrose, si dhe nga trajtimi fiziko-mekanik dhe kimik i metaleve , grumbullohen, transportohen, ruhen/magazinoohen dhe rikuperoohen nga instalimet e linjes se prodhimit te oksidit te zinkut.

- **Stacion transferimi per mbetje te rrezikshme dhe jo te rrezikshme**

Mbetjet te cilat do ti nenshtrohen operacioneve te Riciklimit/riperteritjes natyrisht do te linde nevoja e ruajtjes/magazinimit te perkohshem te tyre deri ne momentin e rikuperimit, per kete arsye nevojitet qe te behet transferimi i perkohshem ne stacionin e transferimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, per arsye se industria gjeneruese e mbetjeve me permbajtje te oksidit te zinkut, i gjeneron ato me kategorine e mbetjeve te rrezikshme dhe mbetjeve jo te rrezikshme. Operatori ka parashikuar qe ky proces te kryhet ne brendesi te siperfaqes se marre me qira, ne vendin e percaktuar nga shoqeria.

Qellimet kryesore te operatorit ALLIANCE RESOURCE Sh.p.k jane:

- Te veproje ne perputhje me kerkesat ligjore shqiptare ne lidhje me mbetjet
- Te zbatoje nje Plan te Menaxhimit te Mbetjeve
- Te shmange hedhjen e mbetjeve ne mjedis
- Te evidentoje, identifikojë, etiketoje/ambalazhoje mbetjet
- Te rikuperoje, ricikloje apo riperdore mbetjet e gjeneruara nga instalimet dhe nga operoret e tjere ne afersi

- Te zbatoje parimet e ekonomise qarkulluese
- Te reduktoje shkarkimet e karbonit ekuivalent ne natyre, me ane te metodave te rikuperimit te mbetjeve
- Te kujdeset per transferimin dhe asgjесimin perfundimtar te mbetjeve qe gjenerohen nga instalimet
- Te minimizoje cdo ndikim mjedisor ose demtimin e ketij mjedisi

**MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

**Programi i Përmirësimit të Procesit të Punës**

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit në linjen e prodhimit të oksidit të zinkut, mbrojtjen nga gazrat, pluhurat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, CO2, NOx, SOx, VOC në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë eficient, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti “ALLIANCE RESOURCE” Sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Erdest Nushi ka hartuar “Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës”, sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

| <b>Spektori</b>                       | <b>Presionet mjedisore</b>  | <b>Ndikimet</b>  | <b>Pershkrimi / masat lehtesuese</b>  |
|---------------------------------------|---|--|---|
| <b>Cilesia e Ajrit</b>                | Emetimi i substancave ndotese (dioksid karboni CO2, LN, NOx, SOx, PM 10, PM 25, O3, H2) nga furra rrotulluese dhe automjetet e transportit, | Vlerat e pritshme jane te ulta krahasuar me normen e cilesise se ajrit. Perdorimi i karburantit, perdorimi i gjeneratorit te energjise, sheshet dhe rruget e brendshme te automjeteve. | Perqendrimi i ulet rekomandohen masa lehtesuese duke perdorur karburant te cilesise se pare. Respektimi i kushteve teknike dhe pastrimi dhe larja e rugeve dhe shesheve, kapja e gazrave dhe pluhurave te gjerneruara nga furra. Mirembajtje e sistemit te kapjes dhe trajtimit te gazrave. |
| <b>Toka dhe ujrato nentokesore</b>    | Prania e ndotesve te mundshem ne toke dhe ujerat nentokesore.   | Ambjenti eshte i sistemuar dhe i shtruar me beton dhe mund te kete perdorim e shkarkime te ujerave te ndotura.   | Te gjitha zonat e magazinimit jane te shtruara dhe pajisur me sistem kanalizimesh. Mundesia e ndotjes se tokes dhe ujerave nentokesore nuk ekziston.  |
| <b>Shkarkimi i Ujrave industriale</b> | Ndotja e ujrave siperfaqesore si rrjedhoje e  | Ndotje e ujerave siperfaqesore pritese, nga shkarkimet e   | Mirembajtja dhe pastrimi i sistemit te kanalizimeve te ujerave te ambjentit.  |

|                        |   |  |   |
|------------------------|---|--|---|
|                        | shkarkimeve te ujerave te aktivitetit per prodhimin e oksidit te zinkut | ujerave te shiut ose larjes se instalimeve, mjeteve, Ujerat e ndotura industriale qe gjenerohen trajtohen, riciklohen dhe riperdoren perseri ne procesin teknologjik | Mirembajtje e sistemit te trajtimit dhe rikuperimit te ujerave  |
| <b>Zhurma</b>          | Emetimi i zhurmave nga procesi i punes.                                 | Funksionimi do te kete ndikime ne ambjentin e punes, por nuk eshte shqetesim per objektet e tjera fqinje, megjithese kufizohet edhe me hapësira te lira.             | Nuk rekomandohen sepse vleresohen ne nivele te lejueshme. Rekomandohet qe punetoret te perdorin mjete mbrojtese per tu mbrojtur nga ndikimi i zhurmes.  |
| <b>Peizazh</b>         | Modifikimi i karakteristikave peisazhore                                | Pajisjet dhe makinerite jane instaluar brenda siperfaqes se marre me qira. Prona eshte i rrethuar me mur per te mos u dukur nga rruget e zones.                      | Operatori ka filluar me mbjelljen e pemeve te larta perreth objektit, ne menyre qe te reduktohet impakti ne mjedis per shkak te demtitimit te peizazhit.  |
| <b>Trafiku</b>         | Rritja e trafikut rrugor  | Proceset per podhimin e oksidit te zinkut ndikojne ne rritjen e numrit te automjeteve qe mundesojne transportin.   | Do te perdoren rruget ekzistuese dhe nuk do te hapen rruge te reja. Infrastruktura eshte ne pergjithesi e mire dhe objekti ndodhet ne afersi te rruges kryesore. Te kufizohet qarkullimi ne pikun e trafikut. |
| <b>Social Ekonomik</b> | Mundesi te reja punesimi  | Gjate funksionimit te instalimeve jane te punesuar disa dhjetera punetore.   | Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative te instalimeve mbi popullsine vendase.  |

|                        |  |  |  |
|------------------------|--|--|--|
| <b>Shendeti Publik</b> | Ndikime ne cilesine e ajrit<br>Zhurma e shkaktuar nga aktiviteti | Perqendrimet e ndotesve te emetuar jane shume te vogla dhe do te jene ne perputhje me gjendjen aktuale te cilesise se ajrit.<br>Nuk parashikohet ndikim ne shendetin e njerezve. | Nje vleresim specifik mbi ndikimin social eshte planifikuar te kryhet per te vleresuar me detaje ndikimet pozitive dhe negative te instalimeve mbi popullsine vendase. Ndikimet vleresohen pozitive ne lidhje me zhvillimin e zones. |
|------------------------|--|--|--|

### Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet Linja për prodhimin e oksidit të zinkut dhe rikuperimin e mbetjeve me përmbajtje të lartë të oksidit të zinkut, Kombinati Metalurgjik Elbasan, Ish Uzina 12, Bradashesh, Elbasan, do të kryhet nga shoqëria **“ALLIANCE RESOURCE”** Sh.p.k, sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Erdest Nushi.

### Parandalimi i aksidenteve dhe reagimet gjatë emergjencave.

Shoqëria **“ALLIANCE RESOURCE”** Sh.p.k ka nënkontraktuar specialistë të ndryshëm të fushës për hartimin e një plani, për funksionimin dhe operimin normal të punës në objektin ku janë instaluar linjat për prodhimin e oksidit të zinkut. Ky plan konsiston në menaxhimin e situatave emergjente që mund të dalin operimit të linjës së instaluar. Synimi i shoqërisë **“ALLIANCE RESOURCE”** është mbrojtja e mjedisit, habitateve natyrore të zonës, sigurimi i jetës së punonjësve, duke krijuar një infrastrukturë dhe kushtet e përshtatshme optimale gjatë zhvillimit të aktivitetit të sajë. Grupi i ekspertëve ka hartuar dhe improvizuar raste të ndryshme të avarive dhe emergjencave që mund të ndodhin në objektin dhe linjën e impiantit, masat që do të ndërmerren dhe grupin përgjegjës të punës për restaurimin dhe rigjenerimin e zonës që mund të jetë objekt i këtyre ndikimeve.

Stimulimi i situatave të ndryshme dhe masa që do të ndërmerren, janë përshkruar në tabelën e mëposhtme:

| <i><b>Situatat e Stimuluara</b></i>                 | <i><b>Ndikimi i mundshëm në mjedis</b></i>   | <i><b>Masat që do të ndërmerren</b></i>   | <i><b>Personi përgjegjës</b></i>           | <i><b>Periudha e ndërhyrjes dhe zgjidhjes së situatës</b></i>   |
|---|--|---|--|---|
| <b>Gjenerimi i Gazrave dhe Grimcave të Pluhurit</b> | - Ndotja e ajrit brenda objektit<br>- Ndotja e ajrit të zones përreth<br>- Dëmtimi i shëndetit të punonjësve dhe mjedisit të zones | - Ndërprerja e menjëhershme e prodhimit<br>- Njoftimi i Përfaqësuesit Ligjor<br>- Sigurimi i shëndetit të punonjësve dhe njoftimi i | Drejtuesi Teknik<br>Punonjësit<br>Shoqëria | - Fikja e menjëhershme e linjes së prodhimit<br>- Njoftimi i Institucioneve Shtetërore për situatën<br>- Nderrimi periodik i filtrave |



|                                    |   |   |                                |  |
|------------------------------------|---|---|--------------------------------|--|
|                                    | - Bllokim i instalimit  | banorëve të zonës<br>- Kapja dhe izolimi i menjëhershëm gazrave dhe pluhurave<br>- Lokalizimi dhe riparimi i menjëhershëm i paisjes që ka shkaktuar ndotjen   |                                | - Mirembajtje e sistemit te trajtimit te gazrave<br>- Pastrimi i zones do të zgjasë deri në momentin e asgjesimit të plotë të ndotjes dhe konfirmimin nga MTM, AKM dhe ISHMPUT per vazhdimin e punes.  |
| <b>Erozioni i tokës</b>            | - Prishje e strukturës së objektit nga lëkundjet e objektit<br>- Prishje, çarje e bazamentit mbajtës të impiantit             | - Njoftimi i Drejtuesit teknik dhe Përfaqësuesit të shoqërisë "ALLIANCE RESOURCE"<br>- Ndërprerja e aktivitetit të prodhimit<br>- Përlllogaritja e dëmit të shkaktuar<br>- Rritja e numrit të punonjësve dhe mjeteve të punës<br>- Riparimi i strukturës së dëmtuar<br>- Përforcimi i objektit bazamentit<br>- Zhblllokimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe teknologjike | Punonjësit dhe Roja i Objektit | -Ndërhyrja duhet të bëhet brenda 4 orëve nga momenti i njoftimit<br>-Punimet për zgjidhjen e problemit dhe riparimin e strukturës/bazamentit/objektit që janë ndikuar nga erozioni do të zgjasin për 1-2 javë pune pa ndërprerje, por edhe më shumë në rastet kur kërkohet, deri në restaurimin tërësor të demit të shkaktuar. |
| <b>Avari teknike të instalimit</b> | - Dëmtimi i linjës së impiantit të prodhimit<br>- Rrjedhje të lubrifikantëve nga mjetet e transportit, ngarkim-shkarkimit etj | Ndërprerja e aktivitetit të prodhimit<br>- Njoftimi i Drejtuesit Teknik për situatën<br>- Kapja, Pastrimi dhe Asgjesimi i rrjedhjeve të   | Punonjësit                     | -Ndërhyrja duhet të bëhet brenda 30 min nga momenti i njoftimit<br>-Punimet për zgjidhjen e avarive teknike duhet të zgjidhen brenda 4 ditëve pune, në rast të kundërt duhet të bëhet zëvendësimi i  |

|                             |   |  |   |   |
|-----------------------------|---|--|---|---|
|                             | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Bllokim i makinerisë</li> </ul>  | <p>mundshme të lubrifikantëve/ grasove/pluhurave.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Riparimi i menjëhershëm i defekteve teknike</li> <li>- Zëvendësimi i pjesëve të demtuara me të reja</li> <li>- Kolaudimi i pajisjeve dhe mjeteve pas riparimit, duke u siguruar ër operimin normal të linjes se asgjesimit</li> </ul>   |   | <p>paisjes me një tjetër deri në riparimin e tij/saj të plotë, për operimin normal të punës për prodhimin e oksidit te zinkut</p>   |
| <b>Rënia e zjarrit</b>      | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Rrezikimi i jetës së punonjësve</li> <li>- Dëmtimi i mjeteve dhe instalime që ndodhen në objekt</li> <li>- Ndotja e ajrit</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërprerja e menjëhershme e punës</li> <li>- Lokalizimi i vendodhjes ku ka rënë zjarri</li> <li>- Njoftimi i PMNZSH dhe Njesisë Vendore</li> <li>- Evakuimi i menjehershem i punonjësve</li> <li>- Paisja e punonjësve me veshje kundra zjarrit</li> <li>- Rrethimi i zonës ku ka rënë zjarr duke e minimizuar përhapjen e tij, në zonën përreth dhe zonat fqinje.</li> <li>- Shuarja e zjarrit dhe sigurimi që nuk ka vatra të tjera aktive</li> </ul> | <p>Punonjësit Perfaqesuesi Ligjor i Shoqerise "ALLIANCE RESOURCE Njësia Vendore</p> | <p>-Ndërhyrja duhet të jetë e menjëhershme deri në shuarjen përfundimtare të zjarrit dhe sigurimit që ngjarja ska më të ngjarë.</p> |
| <b>Aksidentet njerëzore</b> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëmtimi i punonjësve</li> </ul>  | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Skema e punës në objekt do të jetë 2 ose më shumë</li> </ul>  | <p>Punonjësit Drejtuesi Teknik</p>  | <p>-Dhënia e ndihmës së shpejtë do të jetë e menjëhershme</p>   |

|   |  |   |   |  |
|---|--|---|---|--|
|   |  | <p>punonjës së bashku.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Në rast aksidenti, ndihma e parë do ti jepet nga kolegu i punës</li> <li>- Me të ndodhur aksidenti, njoftohen punonjësit e tjerë për situatë e krijuar.</li> <li>- Të aksidentuarit i jepet ndihma e parë me anë të kutisë së shpejtë e cila ndodhet në zyrat e shoqërisë,</li> <li>- Njoftohet menjëherë qendra spitalore më e afërt me anë të telefonit.</li> <li>- Nëse gjendja është e rëndë transporti do të bëhet me mjetin e kompanisë që është në dispozicion për përballimin e situatave emergjente</li> </ul> | <p>Përfaqësuesi Ligjor i Shoqërisë Qendra Spitalore</p> |  |
| <p><b>Dëmtimi i flores dhe faunes</b></p> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dëmtimi i habitateve natyrore</li> <li>- Prishje e ekosistemit</li> </ul> | <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndërprerja e punimeve</li> <li>- Rrethimi i zonës</li> <li>- Dhënia e ndihmës së parë</li> <li>- Njoftimi i Shërbimit Vetëmbrojtës dhe Institucioneve të tjera kompetente</li> </ul>   | <p>Punonjësit Drejtuesi Teknik</p>                      | <p>- Ndërhyrja do të jetë e menjëhershme</p> |

Për menaxhimin sa më të suksesshëm të aksidenteve dhe situatave emergjente, stafi i punonjësve të shoqërisë "ALLIANCE RESOURCE" që operojnë në objektin ku ndodhet instalimi për prodhimin e oksidit të zinkut janë të trajnuar për përballimin e situatave të tilla. Çdo 3 muaj nën kujdesin e Drejtuesit Teknik të

shoqërisë, improvizohen skema të ndryshme për përballimin e situatave të tilla, duke rritur performancën e punonjësve dhe sigurimit të punës brenda objektit/instalimit.

#### - **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

##### **Qëllimet e monitorimit mjedisor**

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për Linjen e prodhimit të oksidit të zinkut është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

##### **Objektivat e Monitorimit:**

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të impiantit.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku janë instaluar instalimet për prodhimin e oksidit të zinkut dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

##### **Baza Ligjore e Monitorimit**

Monitorimi i mjedisit është detyrim ligjor, mënyra, frekuenca dhe elementët e monitorimit janë të ndryshëm për veprimtari të ndryshme.

##### **Kërkesa ligjore për kryerjen e monitorimit:**

- Ligji nr. 10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” i ndryshuar, kreu VI “monitorim i gjendjes së mjedisit”;
- Subjekti është i detyruar të kryejë monitorimet periodike sipas kërkesave të përcaktuara në kushtet e lejes përkatëse mjedisore.

##### **Baza ligjore për monitorim**

|                                   |   |
|-----------------------------------|---|
| Ligji Nr. 10 431, datë 09.06.2011 | Për Mbrojtjen e Mjedisit, i ndryshuar                     |
| Ligji Nr.10266 datë 15.4.2010     | Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja                          |
| Ligji Nr. 9774 datë 12.07.2007    | Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në Mjedis      |
| Ligji Nr. 9115, datë 24.07.2003   | Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura, i ndryshuar |

|                                   |  |
|-----------------------------------|--|
| Ligji Nr. 10 463, datë 22.09.2011 | Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve, i ndryshuar  |
| VKM Nr.1189 datë 18.11.2009       | Për Rregullat dhe Procedurat për Hartimin dhe Zbatimin e Programit Kombëtar të Monitorimit të Mjedisit   |
| VKM nr.103 datë 31.03.2002        | “Për monitorimin e mjedisit në Republikën e Shqipërisë   |
| VKM Nr. 594, date 10.09.2014      | Per miratimin e Strategjise Kombetare per Cilesine e Ajrit te Mjedisit   |
| VKM Nr. 435, datë 12.09.2002      | Për miratimin e normave të shkarkimeve ne ajër në Republikën e Shqipërisë  |
| VKM Nr.248, date 24.04.2003       | Per miratimin e Normave te perkohshme te shkarkimeve ne ajer dhe zbatimin e tyre   |
| VKM Nr. 177, date 31.03.2005      | Per normat e lejuara te shkarkimeve te lengeta dhe kriteret e zonimit te mjediseve ujore pritese   |
| VKM Nr. 803 datë 04.12.2003       | Për miratimin e normave të cilësisë së ajrit   |
| Udhëzimi Nr.8 datë 27.11.2007     | Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara  |
| Vendim Nr. 587, date 07.07.2010   | Per monitorimin dhe kontrollin e nivelit te zhurmave ne qendrat urbane dhe turistike   |
| Udhëzimi Nr. 6527 datë 24.12.2004 | Mbi vlerat e lejueshme të elementëve ndotës të ajrit në mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkarkuar nga mjetet rrugore, dhe mënyra e kontrollit të tyre. I ndryshuar me: Udhëzimin Nr. 12 datë 15.06.2010 |

### Plani i monitorimit

Me qenë se kemi të bëjmë me instalime për Linje per prodhimin e oksidit te zinkut, i pozicionuar ne Kombinati Metalurgjik, Ish Uzina 12, Depo e Koncentratit, Zona Kadastrale 3965, Metalurgji, Bradashesh, Elbasan nevojitet një monitorim i vazhdueshëm, jo vetëm në linjen e prodhimit te oksidit te zinkut, por dhe në një zonë mbi 50m për rreth objektit ku ushtrohet veprimtaria.

Plani i monitorimit do të konsistojë në :

- Monitorimi i parametrave gjeometrike të impiantit të instaluar.
- Monitorimi i zonës së mundëshme të gjenerimit te garave dhe pluhurave
- Monitorimi i sjelljes së bimësisë ekzistuese në zonën përreth objektit dhe marrja e masave për parandalimin e dëmtimit të tyre.
- Monitorim i mbarevajtjes se linjes teknologjike per prodhimin e oksidit te zinkut
- Monitorimi i shkarkimit të ujrave të ndotura urbane dhe industriale që gjenerohen nga aktiviteti i përditshëm i operimit të punës në objekt
- Montorimi i menaxhimit te mbetjeve te gjeneruara nga instalimet dhe mbetjeve nga aktiviteti i perditshem human i punonjesve.

| <b>Cfare</b>                        | <b>Ku</b>                           | <b>Si</b>   | <b>Kur</b>            | <b>Ku</b>   | <b>Kosto</b>  | <b>Kush</b>   |
|-------------------------------------|-------------------------------------|---|-----------------------|---|---|---|
| (eshte parametri per tu monitoruar) | (eshte parametri per tu monitoruar) | (eshte parametri per tu monitoruar)                                 | (Percakto frekuencen) | (eshte monitoruar parametri)  | (nese nuk eshte perfshire ne buxhetin e kompanise)  | (eshte pergjegjes per monitorimin)  |
| Menaxhimii mbetjeve                 | Zonën e prodhimit                   | Proceset e ruajtjes/ magazinimit te mbetjeve teknologjike (sasiore) | Cdo 6 muaj            | Për të siguruar se nuk ka rrezik të ndotjes së mjedisit dhe se eshte bere asgjesimi perfundimtar i tyre | reduktimi i kostove te asgjesimit jashte instalimit | Laborator i akredituar SWOT, Mbikëqyrësi të shqyrtojë dhe të raportojë për te |
| Shkarkimet e lengeta                | Zonën e prodhimit                   | sasiore   | Cdo 6 muaj            | Për të siguruar se nuk ka rrezik të ndotjes së mjedisit   | sipas kontrates                                     | Laborator i akredituar SWOT,  |
| Zhurmat                             | Zonën e prodhimit                   | sasiore   | Cdo 6 muaj            | Për të siguruar funksionimin e duhur  | sipas kontrates                                     | Laborator i akredituar SWOT,  |
| Cilesia e ajrit                     | Zonën e prodhimit                   | sasiore   | Cdo 6 muaj            | Për të siguruar funksionimin e duhur  | sipas kontrates                                     | Laborator i akredituar SWOT,  |
| Eficienca e lendes se pare          | Zonën e prodhimit                   | sasiore (nepermjet monitorimit te mbetjeve)                         | periodike             | Për të siguruar funksionimin e duhur dhe minimizuar kostot  | sipas kontrates                                     | Laborator i akredituar SWOT, Mbikëqyrësi të shqyrtojë dhe të raportojë për te |

Tabela 10. Tabela e monitorimit te planit te menaxhimit

### **Shkarkimet e rasti**

Ndodhin kur lendet ndotese leshohen ne mjedis ne menyre te paplanifikuar. Keto shkarkime ndodhin kur nuk ka pajisje per kontrollin e tyre. Si ti tille mund te jet nje shkarkim nga mosfunsonimi sic duhet I sistemit te filtrave eshte nje shkarkim afat shkruter dhe menjeher duhet te nderpritet puna per riparimin e difektit.

### **Shkarkimet aksidentale**

Shkaktohen nga difektet ne impiantet industriale, nga gabimet ne manipulimin e pajisjeve. Keto shkarkime shkaktojne ndotje shume te larta, por ato ndodhin shume rralle.

Shkarkimet varen me shume nga menyra e punes se impiantit/instalimit, prandaj rezultati duhet te konsiderohet specifik per menyren e punes se burimit gjate marjes se mostres.

### **Monitorimi i burimeve te shkarkimeve te lengeta**

- Shkarkimet e lengeta mund te mos jene homogjene, ne kete rast duhet kujdes ne zgjedhjen e pikave te marrjes se mostres.
- Te njihet ecuria e procesit teknologjik
- Merren disa mostra pergjate seksionit terthor te tubacionit ose kanalit te shkarkimit
- Zgjidhet nje zone me perzierje te mire
- Depozitimi i lendeve te ngurta ndikon ne mostrat e marra prandaj largesia e pikes se marrjes se mostres te jete 25 fishi i diametrit te tubacionit te shkarkimit
- Nese nuk ka zona me homogjenitet te pershtatshem, mostrat te merren nga disa pika pergjate rrymes
- Kur perberja e mostrave ndryshon me kohen, merret nje seri mostrash ose nje perzierje e tyre.

Objektivi i vetëmonitorimit të shkarkimeve në mjedis është të evidentojë vlerat reale të treguesve mjedisorë të gjendjes, ndikimit dhe trysisë në ajër, në ujëra të brendshme, në tokë, me qëllim që, në bazë të tyre, subjekti të ndërmarë masa dhe veprime korrigjuese të përshtatëshme dhe të zbatueshme për zonën ku ushtron aktivitetin. Për rastet kur ka ndotje që ndikojnë në situatën e shëndetit publik dhe në mjedis, të përcaktojë shkallën e ndotjes dhe nivelin e devijimit nga normat e lejuar, në mënyrë që programi rehabilitues të hartohet i sakte dhe masat e ndërhyrjes të jenë ato të duhurat dhe në nivelin e duhur.

Në varësi të nivelit të zhvillimit të ndikimit mjedisor, masat që ndërmeren mund të përfshijnë ndalimin/eliminimin e shkakut të ndikimit, ose mund të jenë të karakterit zbutës e reduktues.

Zgjidhja më e mirë, kur rrethanat e lejojnë, është ndalimi/eliminimi i ndotjes dhe shkaqeve të tjera.

Ne pergatitjen e programit te monitorimit specialistet kane marre ne konsiderate mundesine per te realizuar nje monitorim realist te elementeve me ndikim ne mjedis.

Subjekti merr përsipër sigurimin e ecurisë normale të punës dhe ruajtjen e vazhdueshme të mjedisit deri në mbylljen e aktivitetit.

Subjekti, gjithashtu, do të ketë lidhje të vazhdueshme me Agjensinë Rajonale të Mjedisit Elbasan, pranë të cilës do të informojë periodikisht për mbarvajtjen e punës si gjatë prodhimit të oksidit të zinkut ashtu dhe për monitorimin e parametrave të mësipër.

**Objektivat kryesore të monitorimit janë:**

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të Vendimit Nr.1189. datë 18.11.2009 “Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë”

Frekuenca e monitorimeve është përcaktuar në aktin e miratimit të lejes së mjedisit, sipas kuadrit ligjor çdo 6 muaj të kryhen matjet dhe gjashtë muaj të dorezohet një relacion periodik i shkurtër ku të pasqyrohen punimet e kryera të shoqëruara me foto, masat e marra për reduktimin e ndotjes në mjedis dhe menyrën e zbatimit të kushteve të lejes mjedisore.

**d. KONSULTIMET NDERKUFITARE**

Zona ku zhvillohet do të zhvillohet aktiviteti nuk ka nevojë të nënshtrohet procesit të konsultimit nderkufitar.

**e. AUTORITETI VENDIMARRËS PËR DHENIEN E AKTIT TË MIRATIMIT TË LEJES SË MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QË NDIQEN.**


Autoriteti miratues është Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos për miratimin apo refuzimin e aplikimit për tu pajisur me ndryshimin thelbësor të kushteve të lejes së mjedisit të tipi A, me propozim nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacionin e paraqitur nëpërmjet Qendres Kombëtare të Biznesit.

Afati për marrjen në shqyrtim të aplikimit për pajisjen me leje mjedisit të tipit A është 60 dite pune.

**f. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TË DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NË FORME ELEKTRONIKE, BRENDË 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.**

Faqja zyrtare e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit: [akm.gov.al](http://akm.gov.al)





REPUBLIKA E SHQIPERISE  
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 11699 Prot.

Tiranë, më 4.12 2014

Nr. identifikues 262

## ÇERTIFIKATË

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 122, datë 17.02.2011 Për një ndryshim në Vendimin Nr. 1124, datë 30.7.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave, të procedurave dhe kriterëve për pajisjen me certifikatën e specialistit, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe auditimin mjedisor":

### Z. LAERT SHEHU

Çertifikohet për hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis, për të kryer auditimin mjedisor, për hartimin e ekspertizave për probleme mjedisore dhe thirrjen si ekspert për të vlerësuar një raport të vlerësimit të ndikimit në mjedis ose rezultatet e një auditimi.

*E vlefshme për subjektin "ALLIANCE RESOURCE" Sllp  
për përmirësimin jetikultur*

*Akshnteti: Llogji për prodhimin e durrave të bukut dhe  
hëmbësirave e rubelave të mbledhura dhe jo të  
mbledhura me përmbajtje të durrave të bukut*

MINISTRI

Lefter KOKA



*Kendodhjes: Elborou, Paredostesh, Kolubisrauti Mchologjia,  
1sh zone 12, bepa e koncentrimi, 2k SPGS.*



MINISTRIA E ZHVILLIMIT  
EKONOMIK, TURIZMIT,  
TREGTISË DHE SIPËRMARRJES



Qendra Kombëtare e Biznesit  
National Business Center

Numri serial: LN-2068-09-2016  
NUIS/NIPT: L62113034E

## LICENCË

**Subjekti:** Laert Shehu

**Adresa:** Tirane, TIRANE, Tirane, Njësia Bashkiake nr.4, Rruga Xhanfize Keko, Pallati Andi Konstruksion, Hyrja nr.4, Apartamenti nr.8.

**Kodi:** III.2.A (1+2)

**Data e lëshimit:** 13/09/2017

**Kod tjetër:**

**Afati i vlefshmërisë:** Pa afat

**Emërtimi përshkrues i veprimtarisë**  
Vlerësim i ndikimit në mjedis. Auditim mjedisor

**Kategoria**  
Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis

**Kufizime specifike**  
Licenca ushtrohet sipas kufizimeve në legjislacionin në fuqi

**Nënkategoria**  
Veprimtaritë e ekspertizës lidhur me ndikimin në mjedis

**Detyrime specifike**  
Licenca ushtrohet sipas detyrimeve në legjislacionin në fuqi

**Veprimtari specifike**  
1. Ndikim në mjedis  
2. Auditim mjedisor

**Vendi i kryerjes së veprimtarisë**  
Në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë

**Specialiteti**  
E vlefshme për subjektin "ALLIANCE RESOURCE" Shtet për përmirësimin e  
Ambientit; kështu për prodhimin e oborrit të oborrit dhe ndërtimin e  
mbështetje të orësisë dhe jo kërkeshme me përvojë të  
Oborrit të oborrit.  
Vendodhja: Elbasan, Sadoresh, Follas, kod i identifikimit, 18.10.2017.  
Oligo & kompani shtet 396

**Nënshkrimi i sportelit:** *F. W. W. W.*  
Kjo certifikatë mbetet pronë e Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe duhet të kthehet në rast se ka ndryshim të ndonjë detaji ose ndërprerjet detyrimi ligjor për të qenë person i tatuashëm.

